

VENDIM
Nr. 370, datë 5.6.2024

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, dhe 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718 datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së
(“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT *ISIL (Da’esh)* DHE *AL-QAIDA*

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*”:

1. *Abdikadir; Mohamed; Abdikadir*
2. *Mohamed; Mohamud; Mire*
3. *Mohamed; Omar; Mohamed*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.